



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Java VIII

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

|

Planifikimi i Kostos dhe buxheti

- ▶ Buxheti i projektit dhe krijimi i tij;
- ▶ Menaxhimi i kostos; vlerësimi i kostos;
- ▶ Fondi i kontigjencës në buxhet;



Menaxhimi i Projekteve;

Planifikimi i Kostos dhe buxheti

Buxheti i projektit dhe krijimi i tij;

Menaxhimi i kostos; vlerësimi i kostos;

Fondi i kontigjencës në buxhet;

VLERËSIMI I KOSTOS DHE BUXHETI

- ▶ Buxheti është një plan për alokimin e burimeve.
- ▶ Buxheti shërben si një standard për krahasimin, si një referencë kundrejt së cilës vlerësohet ndryshimi ndërmjet **përdorimit aktual dhe të planifikuar të burimeve**.
- ▶ Buxhetet luajnë një rol të rëndësishëm në gjithë procesin e menaxhimit. Nëse buxhetet nuk lidhen me arritjet, menaxhimi mund të injorojë situatat kur fondet janë shpenzuar shumë më përpara ndonëse janë brenda buxhetit kur shihen sipas periudhës së kohës.

BUXHETI I PROJEKTIT DHE QËLLIMET E ORGANIZATËS

- ▶ Buxheti i një organizate reflekton qëllimet e menaxhmentit.
- ▶ Shtatë faktorët më të zakonshëm që ndikojnë në strukturën e buxhetit janë:

1.Konkurenca

- ▶ Konkurenca e bazuar në kohë.
- ▶ Konkurenca e bazuar në kosto.
- ▶ Konkurenca e bazuar në cilësi.

2.Fitimi

3.Rrjedha e parasë

4.Risku

5.Aftësia teknologjike

6.Burimet

7.Kuptimi I nevojave (qëllimi i nder)

MENAXHIMI I KOSTOS

- ▶ Në shumë mënyra reflekton qëllimet strategjike të ndërmarrjes që ndërmerr projektin, të misionit të saj dhe planit të biznesit.
- ▶ Menaxhimi I kostos përfshin:
 - ▶ grumbullimin e të dhënave, I
 - ▶ logaritjen e kostos dhe kontrollin e kostos,
 - ▶ përgatitjen e raporteve financiare në mënyrë që të krijohet një kuptim I qartë I menaxhimit të parave për projektin.



MENAXHIMI I KOSTOS

- ▶ Burimet më të zakonshme që përfshihen në koston e projektit janë:
 1. Puna e gjallë
 2. Materialet
 3. Nënkontraktorët
 4. Pajisjet dhe fasiliteti
 5. Udhëtimet




KOSTO DIREKTE KUNDREJT ASAJ INDIREKTE

- ▶ Kosto direkte konsiderohen kosto e punës së gjallë dhe materialeve.
- ▶ Kosto indirekte, përgjithësisht lidhet me dy veçori: shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet e përgjithshëm për adrimistrimin.
- ▶ Shpenzimet e përgjithshme përfshijnë: furnizimin me utilitetet e nevojshme, taksat, siguracionet, amortizimin e pajisjeve, pagesat për kontributet shoqërore e shëndetësore të fuqisë puntore.

KOSTO FIKSE KUNDREJT ASAJ VARIABLE

- ▶ Kosto fikse, nuk ndryshon në raport me përdorimin e saj.
- ▶ Kosto variabile janë ato shpenzime të cilat rriten ose ndryshojnë nga përdorimi.



KOSTO NORMALE KUNDREJT ASAJ TË SHPEJTIMIT

- ▶ Kosto normale I referohet atyre shpenzimeve që ndodhin në një proces rutine pune për të përfunduar projektin sipas afatit origjinal të planifikuar.
- ▶ Shpenzimet e përshpejtimit janë kosto të paplanifikuara që ndodhin kur ndërmerren hapat për të shpejtuar përfundimin e projektit.

VLERËSIMI I KOSTOS

- Kryesore për të bërë vlerësimin e kostos së projektit është që së pari të njihet nevoja për të zbërthyer projektin sipas paketave të punës, metodë kjo e vlerësimit të kostos në nivele detyre.

P.sh. do të ishte më e saktë që të identifikohesh kosto e përfundimit të çdo pakete pune në mënyrë individuale dhe më pas të bëhej vlerësimi i kostos totale, sikurse tregohet ne tabelën 11.3

VLERËSIMI I KOSTOS

Aktivitetet e projektit	Kosto e vlerësuar
Përgatitja e vendndodhjes së objektit	
Paketa 1 e punës - Kryerja e matjeve	3.000 €
Paketa 2 e punës – Instalimi i linjave të furnizimit me ujë e energji	15.000 €
Paketa 3 e punës – Pastrimi i sheshit	8.000 €
Paketa 4 e punës – Heqja e shkatërtimeve	3.500 €
Kosto totale e përgatitjes së truallit	29.500 €

Tabela 11.3:
Zbërthimi i
aktiviteteve të
projektit për të
krijuar një vlerësim
të saktë të kostos.

VLERËSIMI I KOSTOS

Ndërmjet metodave më të zakonshme të vlerësimit të kostos janë:

- ▶ Vlerësim I përfaqësues
- ▶ Vlerësim krahasues
- ▶ Vlerësim fizibiliteti
- ▶ Vlerësim definitive



PROBLEMET NË VLERËSIMIN E KOSTOS

Tek projektet që kanë të bëjnë me inovacione të mëdha mund të jetë tepër e vështirë vlerësimi në lidhje me koston.

Ndërmjet arsyeve më të zakonshme të tejkalimit të koston janë:


- ▶ Vlerësimet e ulëta fillestare
- ▶ Vështirësitë teknike të paparashikuara
- ▶ Mungesa e definimit të qartë
- ▶ Ndryshimi i specifikimeve
- ▶ Faktorët e jashtëm



KRIJIMI I BUXHETIT TË PROJEKTIT

- ▶ Buxheti I projektit është plani që identifikon burimet e alokuara, qëllimet e projektit dhe kohëzgjatjen për të lejuar organizatën që të arrijë qëllimet.
- ▶ Buxheti I projektit duhet të koordinohet me aktivitetet e projektit të cilat përcaktohen në strukturën e zbërthimit të punës - SZP.

Krijimi i Buxhetit të Projektit



Sikurse sugjeron figura, SZP përcakton fazat për krijimin e kohëzgjatjes së projektit; buxheti i projektit përcakton burimet e nevojshme për të mbështetur afatin - kohëzgjatjen.

BUXHETIMI NGA LARTË- POSHTË

- ▶ Buxhetimi nga lartë-poshtë kërkon input direkt nga niveli i lartë i menaxhimit të ndërmarrjes; në thelb kjo metodë kërkon së pari që të konsiderojë opinionet dhe eksperiencat e menaxhimit të lartë në lidhje me vlerësimin e kostos së projektit.
- ▶ Ana pozitive e kësaj procedure mund të thuhet se qëndron në faktin se vlerësimet e menaxhimit të lartë të kostos së projektit shpesh janë deri diku të sakta.

BUXHETIMI NGA POSHTË – LARTË

- ▶ Metoda e buxhetimit nga poshtë- lartë fillon nga struktura e zbërthimit për të aplikuar koston direkte dhe atë indirekte për aktivitetet e projektit. Shuma e kostos totale që lidhet me çdo aktivitet më pas agregohet së pari në nivelin e paketës së punës, e më pas në nivel detyre ku të gjithë buxhetet për detyrat kombinohen e agregohen për të krijuar buxhetin e përgjithshëm të projektit.
- ▶ Buxhetimi nga poshtë-lartë e vë theksin tek nevoja për të krijuar plane të detajuara të projektit, veçanërisht struktura të zbërthimit të punës si hapi I parë për alokimin e buxhetit.

KOSTO MBI BAZËN E AKTIVITETEVE

- ▶ Mbështetet tek nocioni që projektet konsumojnë aktivitete dhe aktivitetet konsumojnë burime.

Kosto e bazuar tek aktiviteti përbëhet nga katër hapa :

1. Identifikimi i aktiviteteve që konsumojnë burime dhe caktimi i kostos për to sikurse bëhet në procesin e buxhetimit nga poshtë-lartë.
2. Identifikimi i kostos që lidhet me aktivitetin. Burimet, në formën e personelit të projektit dhe materialet përbëjnë elementët kryesorë të kostos.

KOSTO MBI BAZËN E AKTIVITETEVE

1. Llogaritja e koston për njësi të çdo elementi të koston. P.sh. kosto e punës së gjallë për orë jepet:

Kosto/njësi-----→Kosto në €/ për orë

1. Caktohet kosto për projektet duke shumëzuar koston për njësi për çdo element me volumin e koston për njësi të konsumuar nga projekti. P.sh, supozojmë se kosto e një programuesi softueri është 40 € / orë dhe që ai duhet të punojë për projektin një total kohe prej 80 orë.

Kosto e projektit do të jetë: $40 \text{ € / orë} \times 80 \text{ orë} = 3.200 \text{ €}$

FONDI I KONTIGJENCËS NË BUXHET

- ▶ **Fondi i kontigjences** – përballon efektet e mosrealizimit të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara.
- ▶ Fondi i kontingjencës përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese.



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com